

URDHËR
Nr. 110, datë 13.3.2025

PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË URDHRIN NR. 313, DATË 20.10.2020, TË MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT PSIKOSOCIAL, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE PROCEDURAT E EMËRIMIT, PEZULLIMIT DHE LARGIMIT NË SHËRBIMIN PSIKOSOCIAL”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, nenit 20, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani”,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psikosocial”, i ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë:

a) Kudo në përmbajtje të urdhrit togfjalëshi “Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar” zëvendësohet me togfjalëshin “Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar” dhe shkurtimi “DPAP” zëvendësohet me shkurtimin “AKAP”.

b) Pas pikës 7, të kreut IV, shtohet pika 7/1, me përmbajtje, si më poshtë:

“7/1. Përgjithshëm, në përmbajtje të Komisionit ad-hoc, të ngritur sipas pikës 7, të këtij kreu, për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve të kandidatëve për psikologë/punonjës socialë të cilët në aplikimin e tyre kanë përzgjedhur për punësim ZVAP Shkodër, Divjakë, Berat dhe Kolonjë, caktohet edhe nga 1 (një) përfaqësues nga bashkitë e përfshira në projektin pilot në ushtrimin e përgjegjësi në fushën e arsimit parauniversitar.

Kjo përmbajtje e Komisionit ad-hoc zbatohet sipas kohëzgjatjes së marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet MAS-it dhe bashkisë përkatëse.”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar, Bashkia Shkodër, Bashkia Berat, Bashkia Divjakë, Bashkia Kolonjë dhe institucionet publike të arsimit parauniversitar në territorin e këtyre bashkive.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Orjana Osmani